



Recommendation of the Committee of Ministers to member states concerning new ways of dealing with juvenile delinquency and the role of juvenile justice

Unofficial translation into Albanian

Recommandation du Comité des Ministres aux Etats membres concernant les nouveaux modes de traitement de la délinquance juvénile et le rôle de la justice des mineurs

Traduction non officielle en albanais

Rekomandimi Rec(2003)20 i Komisionit të Ministrave për shtetet anëtare në lidhje me mënyrat e reja të trajtimit të kriminalitetit tek të miturit dhe rolin e drejtësisë për të miturit

© Council of Europe, original English and French versions

Text originated by, and used with the permission of, the Council of Europe. This unofficial translation is published by arrangement with the Council of Europe, but under the sole responsibility of the translator.

* * * * *

© Conseil de l'Europe, versions originales en anglais et français

Le texte original provient du Conseil de l'Europe et est utilisé avec l'accord de celui-ci. Cette traduction est réalisée avec l'autorisation du Conseil de l'Europe mais sous l'unique responsabilité du traducteur.

KËSHILLI I EVROPËS KOMITETI I MINISTRAVE

Rekomandimi Rec(2003)20 i Komisionit të Ministrave për shtetet anëtare në lidhje me mënyrat e reja të trajtimit të kriminalitetit tek të miturit dhe rolin e drejtësisë për të miturit

(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 24 shtator 2003 në mbledhjen e 853-të të Zëvendësministrave)

Komisioni i Ministrave, sipas kushteve të nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës,

Duke marrë parasysh se kriminaliteti tek të miturit perceptohet si një shqetësim i ngutshëm në një numër shtetesh në Evropë;

Të vetëdijshëm për faktin se, edhe pse normat e përgjithshme të krimit tek të miturit mbeten pak a shumë të qëndrueshme, natyra dhe serioziteti i kriminalitetit tek të miturit kërkojnë përgjigje të reja dhe metoda të reja ndërhyrjeje;

Duke marrë në konsideratë se sistemi tradicional i drejtësisë penale më vete mund të mos ofrojë zgjidhje të përshtatshme për sa i përket trajtimit të të miturve që kanë kryer vepra penale, duke qenë se nevojat e tyre specifike arsimore dhe sociale ndryshojnë nga ato të të rriturve;

Të bindur se përgjigjet ndaj kriminalitetit tek të miturit duhet të jenë shumë-disiplinore dhe me përfshirjen e shumë agjencive në përqasjen e tyre dhe se duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të luftojnë serinë e faktorëve që luajnë një rol në nivele të ndryshme të shoqërisë: individualë, familjarë, shkollor dhe të komunitetit;

Duke marrë parasysh se mosha madhore ligjore nuk përputhet detyrimisht me moshën e pjekurisë, që do të thotë se personave të rinj, në moshë madhore që janë autorë të një vepre penale mund t'u nevojiten përgjigje të caktuara të krahasueshme me përgjigjet që jepen për të miturit;

Për më tepër, duke marrë në konsideratë se disa kategori të të miturve që janë autorë të një vepre penale, të tillë si anëtarë të pakicave etnike, vajzat e reja dhe ata që kryejnë një vepër penale në grup, mund të kenë nevojë për programe të veçanta ndërhyrjeje;

Duke marrë parasysh, ndër të tjera, Rekomandimin Nr. R (87) 20 për reagimet sociale ndaj kriminalitetit tek të miturit, Rekomandimin Nr. R (88) 6 për reagimet sociale ndaj kriminalitetit tek të rinjtë që vijnë nga familje imigrantësh dhe Rekomandimin Rec(2000)20 për rolin e ndërhyrjeve të hershme psikologjike-sociale për parandalimin e kriminalitetit;

Duke vlerësuar rezultatin e Bashkëbisedimeve të 10-ta Kriminologjike mbi të rinjtë në moshë madhore që janë autorë të një vepre penale dhe mbi politikën për krimin (1991);

Duke marrë në konsideratë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve, Konventën e Kombeve të Bashkuara për

të Drejtat e Fëmijës, Rregulloren e Kombeve të Bashkuara për Standardin Minimal të Administrimit të Drejtësisë për të Miturit (Rregullorja e Pekinit), Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit tek të Miturit (Udhëzimet e Riadit) dhe Rregulloren e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria;

U rekomandon qeverive të shteteve anëtare që:

- të udhëhiqen në legjislacionin, politikat dhe praktikën e tyre nga parimet dhe masat e parashtruara në këtë rekomandim;
- ta sjellin këtë rekomandim dhe relacionin e tij shoqërues në vëmendjen e gjithë agjencive përkatëse, medias dhe publikut; dhe
- të pranojnë nevojën për rregulla evropiane të veçanta e të dallueshme mbi sanksionet dhe masat në komunitet dhe rregullore evropiane të burgjeve për të miturit.

I. Përkufizime

Në kuadrin e këtij rekomandimi:

- “të mitur” do të thotë persona që kanë arritur moshën e përgjegjësisë penale, por jo moshën madhore; megjithatë, ky rekomandim mund të shtrihet edhe tek ata që janë menjëherë nën dhe mbi këto moshë;
- “kriminalitet” do të thotë veprime që trajtohen sipas së drejtës penale. Në disa shtete, mund të shtrihet edhe në sjellje antisociale dhe/ose devijuese që mund të trajtohet sipas së drejtës administrative ose civile;
- “sistemi i drejtësisë për të miturit” përkufizohet si përbërësi zyrtar i një përqsasjeje më të gjerë për luftuar krimin tek të miturit. Përveç gjykatave të të miturve, ai përfshin organizma ose agjenci zyrtarë si policia, shërbimi i prokurorisë, profesionet ligjore, shërbimin e provës dhe institucionet penale. Ai punon ngushtë me agjencitë e lidhura me të, si shërbimet shëndetësore, arsimore, sociale e të mirëqenies dhe organizmat joqeveritarë, të tilla si mbështetja e viktimës dhe dëshmitarit.

II. Një përqsasje më strategjike

1. Synimet parësore të drejtësisë për të mituri dhe masave të lidhura me të për të luftuar kriminalitetit tek të miturit duhet të jenë:

- i. parandalimi i kryerjes së veprave penale dhe përsëritjeve të tyre;
- ii. (ri)shoqërizimi dhe (ri)integrimi i autorëve të veprave penale; dhe
- iii. adresimi i nevojave dhe interesave të viktimave.

2. Sistemi i drejtësisë për të mituri duhet të shihet si një përbërës i një strategjie më të gjerë me bazë komunitet, për parandalimin e kriminalitetit tek të miturit, një strategji që merr parasysh kontekstin më të gjerë të familjes, shkollës, lagjes dhe grupit të moshatarëve, kontekst brenda të cilit ndodh kryerja e veprës penale.

3. Burimet duhet të kenë veçanërisht në shënjestër adresimin e veprave penale që janë të rënda, të dhunshme, të vazhdueshme e të lidhura me drogën dhe alkoolin.
4. Gjithashtu, duhen të zhvillohen masa më të përshtatshme dhe efektive për parandalimin e kryerjes së veprave penale dhe përsëritjes së tyre nga të rinjtë pjesëtarë të pakicave etnike, grupeve të të miturve, vajzave të reja dhe personave nën moshën e përgjegjësive penale.
5. Ndërhyrjet me të miturit që janë autorë të një vepre penale duhet të bazohen sa më shumë të jetë e mundur në prova shkencore për atë se çfarë funksionon, me kë dhe nën çfarë rrethanash.
6. Në mënyrë që të parandalohet diskriminimi, autoritetet publike duhet të përgatisin deklarata të “ndikimit” në lidhje me pasojat e mundshme të politikave dhe praktikave të reja mbi të rinjtë pjesëtarë të pakicave etnike.

III. Përgjigje të reja

7. Duhet të vazhdojë zgjerimi i serisë së alternativave të përshtatshme përkundrej ndjekjes penale zyrtare. Ato duhet të përbëjnë një pjesë të procedurës së rregullt, duhet të respektojnë parimin e proporcionalitetit, të reflektojnë interesat më të mira të të miturit dhe, në parim, të zbatohen vetëm në raste kur përgjegjësia pranohet lirisht.
8. Për të adresuar veprat penale të rënda, të dhunshme e të vazhdueshme nga të miturit, shtetet anëtare duhet të zhvillojnë një spektër më të gjerë sanksionesh dhe masash efektive në komunitet (por që mbeten proporcionale). Ato duhet të adresojnë drejtpërsëdrejti sjelljen në kundërshtim me ligjin, si dhe nevojat e autorit të veprës penale. Gjithashtu, ato duhet të përfshijnë prindërit ose kujdestarë të tjerë ligjorë të autorit të veprës penale (përveçse kur konsiderohet kundër-produktive) dhe, kur është e mundur dhe e përshtatshme, t'i japin viktimës ndërmjetësim, restaurim dhe rehabilitim.
9. Fajësia duhet të reflektojë më mirë moshën dhe pjekurinë e autorit të veprës penale dhe të jetë më në një hap me fazën e zhvillimit të autorit të veprës penale, ku masat kriminale zbatohen në mënyrë progresive ndërkohë që përgjegjësia individuale rritet.
10. Prindërit (ose kujdestarët ligjorë) duhet të inkurajohen të jenë të vetëdijshëm e të pranojnë përgjegjësitë e tyre në lidhje me sjelljen në kundërshtim me ligjin të fëmijëve. Ata duhet të marrin pjesë në procedimet gjyqësore (përveçse nëse kjo konsiderohet kundër-produktive) dhe, kur është e mundur, duhet t'u ofrohet ndihmë, mbështetje dhe udhëzim. Atyre duhet t'u kërkohet, kur është e përshtatshme, të marrin pjesë në kurse këshillimi ose trajnimit të prindërve, të sigurohen që fëmija i tyre shkon në shkollë dhe të ndihmojnë agjencitë zyrtare në vënien në zbatim të sanksioneve dhe masave në komunitet.
11. Në reflektim të tranzicionit të zgjatur drejt moshës madhore, të rinjtë në moshë madhore nën moshën 21 vjeç duhet të kenë mundësi të trajtohen në mënyrë të krahasueshme me të miturit dhe t'u nënshtrohen të njëjtave ndërhyrje, kur gjykatësi është i mendimit se ata nuk janë aq të pjekur e të përgjegjshëm për veprimet e tyre sa një person plotësisht i rritur.
12. Për të lehtësuar hyrjen e tyre në tregun e punës, duhet bërë çdo përpjekje për t'u siguruar që të rinjve në moshë madhore nën moshën 21 vjeç që janë autorë të një vepre penale të mos u kërkohet të bëjnë publike dosjen e tyre penale punëdhënësve të mundshëm, përveçse kur natyra e punësimit dikton ndryshe.

13. Instrumentet për vlerësimin e rrezikut të përsëritjes së veprave penale në të ardhmen duhet të zhvillohen në mënyrë që natyra, intensiteti dhe kohëzgjatja e ndërhyrjeve të mund të përputhet ngushtë me rrezikun e përsëritjes së veprës penale, si edhe me nevojat e autorit të veprës penale, duke mbajtur gjithmonë në mendje parimin e proporcionalitetit. Aty ku është e përshtatshme, agjencitë përkatëse duhet të inkurajohen të ndajnë informacionin, por gjithmonë në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave.

14. Për pakësimin e vonesave dhe sigurimin e përgjigjes më të shpejtë të mundshme ndaj kryerjes së veprave penale nga të miturit duhen vendosur periudha të shkurtra kohore për çdo fazë të procedimit penal . Në të gjitha rastet, masat për përshpejtimin e drejtësisë dhe përmirësimin e efikasitetit duhet të ekuilibrohen me kërkesat e një procesi të rregullt.

15. Kur të miturit mbahen në paraburgim në komisariat, duhet marrë në konsideratë statusi i tyre si të mitur, mosha dhe gjendja e tyre e cenueshme, si dhe niveli i tyre i pjekurisë. Ata duhet të informohen në kohë për të drejtat dhe garancitë e tyre në mënyrë të tillë që t'i kuptojnë plotësisht. Në parim, gjatë marrjes në pyetje nga policia, ata duhet të shoqërohen nga prindi/kujdestari i tyre ligjor ose nga një i rritur tjetër i përshtatshëm. Ata duhet të kenë gjithashtu, të drejtën e kontaktit me një avokat dhe një mjek. Ata nuk duhet të mbahen në paraburgim në komisariat për më shumë se dyzet e tetë orë në total dhe, për autorët e një veprë penale që janë më të rinj në moshë, duhet bërë çdo përpjekje për uljen edhe më tej të kësaj kohe. Mbajtja e të miturve në paraburgim në komisariat duhet të mbikëqyret nga autoritetet kompetente.

16. Në rastet kur, si masë e fundit, te dyshuarit në moshë të mitur mbahen në arrest me burg, kjo nuk duhet të bëhet për më shumë se gjashtë muaj para nisjes së gjyqimit. Kjo periudhë mund të zgjatet vetëm në rast se një gjyqtar jo i përfshirë në hetimin e çështjes është i bindur se çdo vonesë në procedim është plotësisht e justifikueshme nga rrethana të jashtëzakonshme.

17. Aty ku është e mundur, duhen përdorur alternativa ndaj arrestit me burg të të dyshuarve në moshë të mitur, alternativa si vendosja me të afërmit, familje kujdestare ose forma të tjera të akomodimit me përkrahje. Arresti me burg nuk duhet të përdoret kurrë si ndëshkim ose formë kanosjeje ose si një zëvendësues i masave të mbrojtjes së fëmijës ose të shëndetit mendor.

18. Në vlerësimin e parandalimit të veprave penale të mëtejshme me anë të ndalimit ose jo në arrest me burg të një të dyshuari në moshë të mitur, gjykatat duhet të ndërmarrin një vlerësim të plotë të rrezikut bazuar në informacion tërësor dhe të besueshëm mbi personalitetin e të riut dhe mbi rrethanat sociale.

19. Përgatitja për lirin e të miturve të privuar nga liria duhet të fillojë në ditën e parë të dënimit të tyre. Vlerësim i plotë i nevojave dhe rrezikut duhet të jetë hapi i parë drejt një plani ri-integrimit i cili t'i përgatisë plotësisht për lirim autorët e veprave penale duke adresuar, në mënyrë të bashkërenduar, nevojat e tyre në lidhje me arsimin, punësimin, të ardhurat, shëndetin, strehimin, mbikëqyrjen, familjen dhe mjedisin social.

20. Duhet të përdoret një metodë e ndarë në faza për ri-integrimin, duke përdorur periudha lejeje, institucione të hapura, lirim më përpara me lejen e autoriteteve (on licence) dhe njësitë e risistemimit. Burime duhen investuar në masat e rehabilitimit pas lirimimit dhe kjo duhet , në të gjitha rastet, të planifikohet e të kryhet me bashkëpunimin e ngushtë të agjencive të jashtme.

IV. Zbatimi

21. Përgjigja ndaj kriminalitetit tek të miturit duhet të planifikohet, bashkërendohet dhe jepet nga partneritetet lokale që përbëhen nga agjencitë publike kyçe –policia, shërbimi i provës, autoritete të rinisë dhe mirëqenies sociale, gjyqësore, të arsimit, punësimit, shëndetit dhe strehimit- dhe sektori vullnetar e privat. Partneritete të tilla duhet të jenë përgjegjëse dhe llogaridhënëse për arritjen e një synimi të përbashkët e të përcaktuar qartë, dhe për:

- dhënien e trajnimit fillestar dhe në shërbim;
- planifikimin, financimin dhe kryerjen e shërbimeve;
- vendosjen e standardeve dhe monitorimin e performancës;
- ndarjen e informacionit (që i përmbahet kërkesave të mbrojtjes së të dhënave dhe fshehtësisë profesionale dhe duke marrë parasysh detyrat specifike të agjencive të interesuara); dhe
- vlerësimin e efikasitetit dhe shpërndarjen e praktikës së mirë.

V. Të drejtat dhe garancitë

22. Të gjitha përgjigjet dhe procedurat e reja të përmbajtura në rekomandimin aktual duhet të konsiderohen brenda kornizës së të drejtave dhe garancive të paraqitura në instrumentet ndërkombëtare përkatëse.

VI. Monitorimi, vlerësimi dhe shpërndarja e informacionit

23. Për të rritur bazën e njohjes se cilat ndërhyrje funksionojnë, duhen caktuar fonde për vlerësimin e pavarur shkencor të ndërhyrjeve të tilla dhe për shpërndarjen e gjetjeve tek profesionistët përkatës.

24. Për të parandaluar diskriminimin mbi baza etnike brenda sistemit të drejtësisë për të miturit dhe për të identifikuar rastet kur kërkohen ndërhyrje specifike për kulturën, duhet të mblidhet informacion dhe/ose të bëhen kërkime mbi përfshirjen dhe trajtimin e pakicave etnike në secilën fazë të sistemit të drejtësisë për të mitur.

25. Për t'iu kundërvënë perceptimeve tejet negative, për të informuar opinionin publik dhe për të rritur besimin e publikut, duhen zhvilluar strategji të informacionit mbi kriminalitetin tek të miturit, si dhe punën dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë për të mitur, duke përdorur një gamë të gjerë burimesh, përfshirë këtu televizionin dhe internetin. Kjo duhet të arrihet pa vënë në dispozicion informacione personale ose të dhëna të tjera që mund të çojnë në identifikimin individual të një autori të një veprje penale ose viktime.